

# DIMAN GLOBE 69 WG

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE

KLASA: 3



“KUJDES”

I RREZIKSHEM PER MJEDISIN. N.

Frazat e rrezikut: R43; R50/53. Frazat e sigurise: S2; S13; S2021; S36/37; S46; S60; S61.

**Diman Globe 69 WG** eshte fungicid me veprim lokal-sistemi dhe kontakti, i cili perdoret me efektivitet te larte ne luftimin e vrugut ne hardhi, patate, domate, trangull e perime te tjera.

**Lenda vepruese:** 60 % Mancozeb + 9 % Dimethomorph.

**Formulimi:** Granula te dispergueshme ne uje (WG).

**Masat parambrojtese:**

- Mbajeni ne vende te sigurta dhe te pa ariteshme nga femijet.
- Ruajeni ne vende te thata dhe te fresketa, larg ushqimeve, pijeve dhe ushqimeve per blegtorine.
- Evitoni kontaktet e zgjatura te syve dhe lekures me preparatin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymemarrjes gjate pregatitjes se solucionit sperkates dhe gjate sperkatjes.
- Gjate perdorimit te tij mos ha e mos pi uje dhe duhan.
- Gjate punes perdor paisje mbrojtese: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Ne perfundim te punes lani duart dhe pjeset e ekspozuara te trupit si dhe paisjet mbrojtese, mjetet sperkatese.
- Beni shkaterrimin e ambalazhit sipas rregullave ne fuqi.

**Udhetime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekim:**

- Ne rast kontakti me lekuren ose mukozat lahuni me uje te bolleshem dhe sapun.
- Ne rast thithje te tretesires sperkatese me organet e frymemarrjes i aksidentuari cohet ne nje mjedis te ngrohte dhe te ajrosur
- Ne rast helmimi kerconi menjehere ndihme ne qendren me te afert spitalore duke i treguar mjekut etiketen e ketij produkti.
- Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi sipas simptomave.

**Perdorimi:**

**Diman Globe 69 WG**, ne saje te permbajtjes te Dimetomorfinit dhe Mankozebit, eshte nje kombinim teper efektiv, me veprim lokal-sistematik dhe kontakti, per kontrollin e vrugut, njeres prej semundjeve me te njohura ne mjaft prej kulturave bujqesore si hardhi, patate, domate, trangull, bostan, etj. Karakterizohet nga nje mekanizem veprimi specifik duke mos shkaktoar fenomene te krosrezistences me fungicidet sistemike te grupeve te tjera.

**Ne vreshhta:** Perdoret ne infeksionet e hereshme te gjethëve dhe ne vazhdim te vegjetacionit, ne infeksionet e voneshme te gjethes, si dhe ne infeksionet ne veshul. Megjithese ka ne perberje Dimetomorfinit, perseri rekomandohet per t'u perdorur ne periudha te hereshme pasi

te kemi konstatuar semundjen. Duke trajtuar heret kur lastari ka aritur 10 cm dhe kur brenda nje dite kane rene te pakten 10 mm reshje (por jo me vone se dy tre dite pas renies se shirave infektuese) produkti ne saje te depertimit me shpejtesi ne indet gjethore e mbron bimen nga infeksionet e para duke dhene efektin maksimal.

**Diman Globe 69 WG** ndikon ne fuqizimin e lastareve dhe mases vegjetative ne saje te permbajtjes se zinkut dhe manganit sidomos ne ato vreshtha qe kane mangesi ne mikroplehra. Doza e perdorimit 250 gr preparat/100 lit uje.

**Ne patate:** Rekomandohet te fillohen trajtimet sa me heret, kur kushtet e motit apo sherbimi i prognozës paracakton shfaqjen e semundjes.

Trajtimet duhet te perseriten çdo 10-14dite. Kur kushtet e motit favorizojne zhvillimin e vrugut intervalet midis trajtimeve mund te shkojne edhe 7 dite.

Perdorimi i mjeteve sperkatese cilesore eshte i rendesishem dhe, ne vartesi te vegjetacionit sasia e ujit te perdorur mund te shkoje 400-800 lit/ha duke perdorur 2 kg preparat/ha.

**Ne domate, trangull, bostan:** Doza e perdorimit, 250 gr preparat/100 lit uje.

**Verejtje per perdorimin:**

**Diman Globe 69 WG** mund te perzihet me fungicidet, insekticidet si dhe me pleherat gjethore.

**Fitotoksiciteti:**

Nuk eshte fitotoksik kur perdoret me dozat dhe ne kulturat e rekomanduara.

**Ndikimi ne ekosistem:**

Nuk eshte demtues ndaj bleteve dhe peshqve.

**Karenca:**

20 dite per te gjithë kulturat ku rekomandohet.

**Magazinimi:**

Ruhet ne vende te errta, te fresketa dhe ne ambalazh origjinal.

Nr dhe data e regjistrimit: 595, datë 06.07.2015.

Sasia neto: **ADD HERE THE NET WEIGHT**

Data e prodhimit: **TETOR 2015**

Periudha e ruajtjes: 3 vjet;

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: **Zenith CropSciences Bulgaria. Asenovgradsko Shose, 4009 Plovdiv, Bulgaria.**

Emri dhe adresa e Aplikantit: **Zenith CropSciences Bulgaria. Asenovgradsko Shose, 4009 Plovdiv, Bulgaria.**